



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES

I.Numër: 400-01-69810, datë: 29 Shtator 2025.

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12. 2. pika d) të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 14 të Rregullores (KPE) Nr.01/2020 për Organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në territorin e Komunës së Pejës, I.Numër:352-01/21640, dt. 29.maj 2020, nenit 20.paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenin 64. paragrafi 1, të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431, datë: 30.Shtator 2020, ne propozim të kryetarit të Komunës, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 29 Shtator 2025, merr këtë:

VENDIM

Nr.66/2025

Mbi kompensimin e kryesuesve të Këshillave Lokal në Komunën e Pejës për vitin 2025

- 1.MIRATOHET vendimi për kompensimin e kryesuesve të Këshillave Lokal në Komunën e Pejës, për vitin 2025, në shumën prej 300,00 € (treqind euro).
2. Kompensimi për kryesuesit e Këshillave Lokal, do të behet për vitin 2025, sipas pikës 1 të këtij vendimi dhe mandatit të caktuar me Rregullore, për mbulimin e shpenzimeve të tyre gjatë ushtrimit të detyrës.
3. Kompensimi nga pika 1 e këtij vendimi do të bëhet nga buxheti Komunal, Kodi për mallra dhe shërbime i Drejtorisë për Administratë të Komunës së Pejës.
4. Për Zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës, në bashkëpunim me Drejtorin për Buxhet e Financa dhe Drejtorinë për Administratës.
5. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

MAPL,
Kryetarit të Komunës,
Drejtorisë për Administratë,
Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
Arkivë.



KRYESUESI I KUVENDIT,
Z. Rexhep Kurtbogaj